



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"

VLOPË

ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS

NR. 1904 PROT.

DATA 18. 07. 2025

Nr. 4546/2 Prot.

Tiranë, më 16. 07. 2025

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË


Adresa: Skelë, Rruga "Kosova", 9401, Vlorë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 337, datë 16. 07. 25 "Për hapjen e programit të studimit me karakter profesional në "Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare", në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4546 / Prot.

Tiranë, më 16.07. 2025

URDHËR

NR. 337, DATË 16.07.2025

PËR

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË
“SPECIALIST NË SHËRBIME DHE OPERACIONE DETARE”, NË UNIVERSITETIN
“ISMAIL QEMALI”, VLORË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 72, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe shkronjës “g”, të pikës 2, të urdhrit nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

- Hapjen e programit të studimit me karakter profesional në “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare”, me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kod 52PP0788S.
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet “Diplomë profesionale” në “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare”, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
- Veprimtaria akademike në programin e studimit me karakter profesional në “Specialist në Shërbime dhe Operacione Detare”, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, fillon sipas legjislacionit në fuqi.
- Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.

6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ

